



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërin anë;

Dhe

GRUPI I OE "BENITA COMPANY" & "ASFALT GROUP" Shpk nga Komuna e Klinës të cilën e përfaqëson z. Emin Demaku, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810313213 & 810082397 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I RRUGËVE NË TOMOC – LOT 2 –Projekt Ministrisë së Infrastrukturaes dhe Ambientit 2020-2021

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-4834 - 5-2-1/ C 404 LOT 2</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 065 / 521</i>

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I RRUGËVE NE TOMOC -LOT 2

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit: NDËRTIMI I RRUGËVE NË TOMOC-LOT 2 është: 68.159,50 € dhe me fjalë:

Gjashtëdhjetëtetë mijë njëqind e pesë dhjetë nëntë euro €

2.2 Vlera prej 40.000,00 do të realizohet në vitin buxhetor 2020, ndërsa, vlera tjetër deri në përmbushjen e kontratës, do të realizohet në vitin buxhetor 2021

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të fillonë të realizohet pas nënshkrimit të sajë dhe do të përmbushet në afat prej 12 muajsh, nga data e nënshkrimit të së njëjtës, përkatesisht me së larti deri me: 30.11.2021

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet në afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të përgjigjet për demet eventuale që mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për: Autoritetin Kontraktues:
KOMUNA E ISTOGUT**

**Për: Kontraktuesin:
GOE "Benita Company"
& "Asfalt Group" Shpk**

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Hesen Kalludra
Pozita:	U.D. I Menaxher-it të Prokurimit	Pozita:	P r o n a r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13. 11. 2020	Data:	13, 11, 2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbuloohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë;gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri 1 muaj me gjate se perfundimi i kontrates.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>12 muaj</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25%</i> për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është përgjegjës per realizimin e punimeve sipas përshkrimi ,kualiteti dhe kuantiteti.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë <i>}}</i> .

KOMUNA E ISTOGUT

TITULLI I AKTIVITETIT

PARAMASA DHE PARALLOGARIA-Asfaltimi i rrugëve në Tomoc

	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
Rrugët të cilat janë të parapara të asfaltohen në fshatin Tomoc janë si në vijim: Rruga "Haxhi Rexha" me degëzime L=500m,d=4m dhe L=200,d=3m,Rruga "Elez Tahiri" L=160m,d=3m,Rruga "Ramë Lybeniqi" L=150m,d=4m,rruga "Ramë Haliti" L=300m,d=4m,Rruga të lagja Sylaj L=160m,d=3m.Rruga të lagja Lulve L=40m,d=3m,lagja Bardhaj L=100m,d=3m lagja Imerovit L=80m,d=3m dhe lagja Kabashi L=70m,d=3m.Lagja Selmanovit L=80m d=3m					
1	Punët përgaditore				
1.1	Mobilizimi i ndermarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e perplimit të planit dhe programit punues si dhe gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i perkohshëm i tyre	aprox	1,00	200.00	200.00
1.2	Pastrimi i terrenit nga shkurret me prerje, ngarkim dhe bartje deri në deponi, Prerja e drunjeve me diametër 0-20cm përgjatë trupit të rrugës si dhe nxerja e cungave me ngarkim dhe bartje deri në deponi max 5 km	m ³	200.00	0.50	100.00
1.3	Demolimi i rrethojave metalike prej telave me gjemba dhe demolime të tjera të mundshme si shtylla etj, ngarkimi dhe bartja deri në deponinë e qytetit deri në 5km distancë	m ³	1,000.00	2.00	2,000.00
1.4	Sanimi i trasës para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit	m ³	1,800.00	0.40	720.00
subtotali					3,020.00
2	Punimet e dheut				
2.1	Germimi i dheut të kategorisë III-IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 5km. Germimi të behet në thellesi deri në 30cm	m ³	2,000.00	1.00	2,000.00
2.2	Rrafshimi i nenbazës me ngjeshje me vibrocilinder deri në 30MN/m ²	m ²	8,000.00	0.10	800.00
2.3	Punimi i bankinave me trashësi t=10cm dhe gjerësi 0.5m me zhavor 0-31.5mm me ngjeshje- duke përfshirë përfshirë udhëkryqet dhe rrugët lidhëse me bankinen e rrugës	m ³	180.00	4.00	720.00
2.4	Ngritja e pusëve të kanalizimit, punimi i kokave të tyre. Në llogari të parashihet edhe vendosja e kapakeve nga Giza me aftësi mbajtëse 40Ton	copë	14.00	150.00	2,100.00
2.5	Te behet dislokimi i shtyllave të rrjetit elektrik nga materiali drunor dhe vendosja e tyre në vende tjera sipas udhëzimeve të KEDS dhe pelqimit nga komuniteti. Në llogari të parashihet edhe paisja me pelqim nga ana e kompanisë KEDS-I për dislokim	copë	5.00	100.00	500.00
subtotali					6,120.00
3	Mbistruktura				
3.1	Punimi i tamponit 120MN/m ² prej gurit të thyer gelqeror 0=63mm me trashësi t=20cm	m ³	1,510.00	3.50	5,285.00
3.2	Punimi i tamponit 120MN/m ² prej gurit të thyer gelqeror 0=32mm me trashësi t=10cm	m ³	755.00	4.00	3,020.00
3.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e Asfalt betonit 0-16mm me trashësi t=7cm për tërë sipërfaqen e rrugës dhe atë me gjerësi 4m dhe 3m	m ²	6,600.00	6.30	41,580.00
3.4	Te punohet rrjetit i kanalizimit, prapakisht vendosjes së asfaltit në lagjen të Imerovit me gjatësi 150m. Në llogari të parashihet, germimi dhe hapja e kanalit për vendosjen e gypave Ø200, furnizimi dhe vendosja e tyre në veper, furnizimi dhe vendosja e reses, furnizimi dhe vendosja e pusëve 5 copë, kryerja e të gjitha aktivitetve tjera profesionale, mbyllja e kanalit dhe kthimi i terrenit në gjendjen e mëparshme	m	150.00	20.00	3,000.00
subtotali					52,885.00

	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
Paramasa dhe parallogaria për Ndertimin e Urës në Tomoc-Ura me dim:6.00x4.00M					
1	Punet tokësore				
	Germimi I dheut të kategorisë lidhe IV me makinë dhe dorë me gjerësi dhe thellësi sipas profilit gjatësor				
1.1	Me makinë 90%	m ³	15.00	1.00	15.00
1.2	Me dorë 10%	m ³	1.50	1.00	1.50
1.3	Ngarkimi dhe transporti I dheut të germuar për mbushjen e anësorëve-skarpateve të urës nga zhavori natyral	m ³	250.00	1.00	250.00
1.4	Planifikimi I fundit të kanalit me dorë me saktësi +/- 1cm si dhe ngjeshja e bazës me cilindër.	m ²	10.00	1.00	10.00
1.5	Mbushja,shperndarja dhe ngjeshja(kompaktimi) i dheut në shtresa(20-30)cm buzë kanalit të punuar e sipas detaleve te parqitura në projekt	m ²	50.00	1.00	50.00
1.6	Furnizimi,transporti dhe ngjeshja e zhavorit0-31mm nën pllakën e betonit të varfur të terë kanalit në gjatësinë e tij	m ³	12.00	4.00	48.00
Totali i punëve tokësore					374.50
2	Punët e Betonimit				
2.1	Furnizimi,transporti dhe betonimi I mureve të urës me beton te klasit MB-30 duke llogaritur ne përkrahjet e nevojshme-pahit e duhura Në çmim te kalkulohen edhe betonimi i shputave duke u bazuar në proejkt	m ³	40.00	60.00	2,400.00
2.2	Furnizimi,transporti dhe betonimi I pllakës të urës me beton MB-30 duke llogaritur ne perkrahjet tjera-pahit e duhura per ketë aktivitet	m ³	15.00	60.00	900.00
2.3	Furnizimi,transporti dhe betonimi I murëve në vazhdim të urës me beton MB-30 me pahi te duhura për ketë aktivitet.Në llogari te futet edhe betonimi I shputave të urës duke u bazuar në skicë projekt	m ³	15.00	60.00	900.00
Totali i punëve të betonit					4,200.00
3	Punët e Armaturës				
3.1	Furnizimi dhe Armimi I pjesëve të kanalit sipas detaleve të armaturës.Çmimi për njësi përfshin,Furnizimin,transportin,prerjen dhe lakimin si dhe vendosjen ne veper të Armaturës Ø12mm-10/10 sipas detaleve në proejkt	kg	1,500.00	0.80	1,200.00
3.2	Blerja,transporti dhe punimi I parrmakëve të Urës në te dy anët e saj:Punimi të behet nga konstruksioni metalik dhe atë si ne foto.Lartësia h= 1m	m ²	9.00	40.00	360.00
Totali I puneve te Armaturës					1,560.00
LOTO2 - TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					68,159.50

